

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SKANDAL pas aksidentit në shtëpinë e aktorit turk Kivanç Tatlıtuğ, dalin në dritë akuzat TRONDITËSE! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/skandal-pas-aksidentit-ne-shtepine-e-aktorit-turk-kivanc-tatlitug-dalin-ne-drite-akuzat-tronditese/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 08:10:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 07:54:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f551b3b6d3b28513cfff1689e75ea22dee0f43de5b6d46904e6414c9bb1c650cf
TEKSTI	1c9329c5c46f13c0af603f77323cd3f66478aa3c66bff9f163fccecfb389aaeb
PAMJA	f0ff51d5ce9e44b79d491c95e79219d80300f7c88da32df1a25727563abc83c8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	28998f1814005b16194bb7678370c904259f861808846e95f2a64bb2f5be0db1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9a66b9440a0861df2d438551387cc4c0076e19988df5fe9b1c9268bd2c93d904
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/28998f1814005b16194bb7678370c904259f861808846e95f2a64bb2f5be0db1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

SKANDAL pas aksidentit në shtëpinë e aktorit turk Kıvanç Tatlıtuğ, dalin në dritë akuzat TRONDITËSE!



Marisa Karabeci
16 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Ajo që nisi si një aksident i rëndë në shtëpinë e Kıvanç Tatlıtuğ në Stamboll, tashmë është kthyer në një çështje që po merr përmasa të tjera. Pas rrëzimit të një punëtori nga çatia e pronës së aktorit, në skenë ka dalë një marrëveshje e diskutueshme, akuza për dokument që datuar në mënyrë retroaktive dhe një kallëzim penal që përfshin emrin e Tatlıtuğ. Ngjarja e rëndë ndodhi më 31 gusht në pronën e aktorit në Göktürk, në pjesën evropiane të Stambollit. Bahadır Yangibayev, shtetas nga Turkmenistani, i cili ishte sjellë për punë pastrimi, u rrëzua nga çatia dhe pësoi dëmtime serioze. Ai u dërgua në terapi intensive, ndërsa menjëherë pas incidentit nisën hetimet për të zbardhur përgjegjësitë.

Në qendër të hetimit u vendos A.A., pronari i kompanisë që po kryente punimet e rinovimit në pronën e aktorit. Ai u mor në pyetje nga autoritetet, por deklaroi se Yangibayev nuk ishte punonjës i tij dhe se nuk i kishte dhënë asnjë udhëzim për të dalë në çati. Më pas, A.A. u la i lirë nën kontroll gjyqësor. Por pikërisht këtu historia mori një kthesë të papritur.

A.A. pretendon se ndërsa ndodhej në komisarjat, një avokat që ai e identifikoi si përfaqësues të Kıvanç Tatlıtuğ shkoi ta takonte dhe i kërkoi të firmoste një dokument prej tre faqesh. Sipas tij, në faqen e parë përmendej vetëm puna e “lyerjes dhe rinovimit”, ndërsa më vonë ai dyshoi se dokumenti mund të ishte datuar pas faktit, duke tentuar sipas pretendimeve të tij të zhvendoste përgjegjësinë për aksidentin te kompania e tij.

Pretendimet janë bërë tashmë pjesë e një beteje ligjore. Avokatja e A.A., Fatma Uluca Telli, ka paraqitur kallëzim penal ndaj Tatlıtuğ dhe avokatit I.A., duke kërkuar edhe ekzaminimin e dokumentit origjinal. Por nuk mbaron këtu. Në kallëzim pretendohet gjithashtu se vullneti i A.A. mund të jetë cenuar në momentin kur ai firmosi marrëveshjen. Ndërkohë, një kërkesë tjetër është

paraqitur pranë Dhomës së Avokause së Stambullit, ku kerkonet nisa e procedurave disipinore ndaj avokatit I.A. për pretendime lidhur me përdorimin e pozitës së tij profesionale.

Nga ana tjetër, avokati i Kıvanç Tatlıtuğ ka kundërshtuar pretendimet që janë bërë publike rreth çështjes. Pra, ndërsa një aksident në pronën e aktorit po hetohet nga autoritetet, tashmë përballë njëri-tjetrit janë edhe versione të ndryshme mbi një dokument që mund të jetë bërë pjesë e rëndësishme e dosjes. Hetimi vijon, ndërsa mbetet për t'u zbardhur se çfarë ka ndodhur realisht në pronën e aktorit dhe nëse dokumenti i firmosur do të luajë një rol kyç në përcaktimin e përgjegjësjve.

LAJME TË NGJASHME



Aktori bukurorsh turk shkaktoi polemika me daljen e tij të fundit!

1 MIN



Aktori i njohur mesa duket e ka ndarë mendjen, emrin i rolit të tij të famshëm do t'i vendoset djalit të tij!

1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Reshje shiu në zonat malore dhe temperatura deri në 32°C, parashikimi i motit për sot



Gjykata speciale në Hagë jep sot vendimin për Thaçin dhe ish-krerët e tjerë të UÇK-së



Kush janë gjyqtarët që do të shpallin sot vendimin për ish-krerët e UÇK-së në Hagë?



Tension para Speciales në Hagë/ Policia holandeze përplaslet me mbështetësit e ish-krerëve të UÇK-së!



FOTOT bëhen virale në rrjet/Pëson diarre gjatë garës, atletja nuk NDALET!



Rrëzohet kërkesa e Ilir Metës për lirim nga burgu!



Biletat për ndeshjet e Shqipërisë, edhe fizikisht pranë "Air



"Burri e tradhtonte me shokun e ngushtë..."/ Shkënda Lili habit



Arresti i Erion Veliaj, sot çështja në Gjykatën e Lartë!



Oasis nuk ndalen! Liam dhe Noel Gallagher rikthehen sërish

EDITORI SUGJERON



Një natë, shumë ritme dhe një ndalesë që nuk e kishim planifikuar!



Nga dëshira për të prekur "Eurovisionin" deri tek situata më e sikletshme në koncert, flet Lorenc Hasrama!



"Po sikur...?" Ja si mendimet më të zakonshme na fusin në alarm...



"Po du", Rilind Alimani tregon si arriti të realizojë bashkëpunimin me Elvana Gjatën: I kam shkruar që...



Truku i thjeshtë që ua heq lëkurën specave pa mundim, mjafton një hap pas pjekjes!



"Eksperimentova, shkoj shumë mirë"/Egli Tako flet për projektet e saj muzikore: Do kthehem tek baladat...



Të dobët dhe e keni të vështirë të shtoni peshë?! Proveni këto ushqime...



Të gjithë po shtojnë ekrane, Range Rover po bën të kundërtën!



Jeni të mërzhitur?! Bëni mirë të hani këto ushqime...



Mendoni se partneri juaj po ju tradhton?! Ja se si duhet të flisni me atë...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania

Email:

Tel: +355 69 208 0500

+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontaktimi
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.